



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT
TË PUSHTETIT LOKAL

RAPORTI I ZBATIMIT TË PLANIT TË PUNËS SË MINISTRISË SË ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL

JANAR – DHJETOR 2025



Ish "Rilindja"
Kati: 11, 12 dhe 13 Prishtinë,
Republika e Kosovës



+383 (0) 38 200 64 001



<https://mapl.rks-gov.net/>

Prishtinë, janar 2026

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	3
HYRJE	4
I. RITJA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL PËRMES MBËSHTETJES FINANCIARE TË KOMUNAVE TË BAZUAR NË PERFORMANCË	6
1.1. Zhvillimi i Kuadrit Strategjik për Zhvillim Ekonomik Lokal	6
1.2. Financimi i Projekteve të Komunave	7
1.3. Vlerësimi i Performancës Komunale	8
II. AVANCIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL, KOMUNAL NDËRKOMBËTAR DHE NDËRKUFITAR	9
2.1. Bashkëpunimi komunal ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar	9
2.2. Zbatimi i Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar	11
2.3. Kontrolli i programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar	13
III. AVANCIMI I POLITIKAVE DHE I KORNIZËS LIGJORE PËR VETËQEVERISJEN LOKALE	13
3.1. Zhvillimi i Akteve Ligjore dhe Nënligjore	14
3.2. Vlerësimi i Ndikimit të Politikave në Fushën e Vetëqeverisjes Lokale	16
3.3. Adresimi i Obligimeve nga Agjenda Evropiane	16
3.4. Koordinimi i Politikave	17
IV. PROMOVIMI I QEVERISJES SË MIRË, RITJA E TRANSPARENCËS KOMUNALE, MBROJTJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE ZHVILLIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE	18
4.1. Transparenca dhe Llogaridhënia Komunale	18
4.2. Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut	19
4.3. Zhvillimi i kapaciteteve institucionale	22
V. AVANCIMI I QEVERISJES SË HAPUR DHE I SHËRBIMEVE DIGJITALE NË NIVEL LOKAL	23
5.1. Zhvillimi i Platformës Shtetërore E-Komunat	23
5.2. Avancimi i partneritetit për qeverisje të hapur	25
5.3. Bashkëpunimi me Shoqërinë Civile	26
5.4. Informimi i Publikut për Aktivitetet e MAPL-së	26

VI. ADMINISTRATA, SHËRBIMET E PËRGJITHSHME, FINANCAT, AUDITIMI DHE PROKURIMI	27
6.1. Menaxhimi i burimeve njerëzore	27
6.2. Shërbimet e Përgjithshme.....	27
6.3. Menaxhimi i financave.....	28
6.4. Auditimi i Brendshëm.....	30
6.5. Prokurimi.....	31

SHKURTESAT

AE	Agjenda Evropiane
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
BB	Banka Botërore
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative
ECDC	Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
IE	Integrimet Evropiane
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
LVL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MFT	Ministria e Financave dhe Transfere
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MSA	Marrëveshja për Stabilizim Asociim
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PL	Pushteti Lokal
PKZMSA	Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
PQ	Pushteti Qendror
QPKS	Qendra për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjeve
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
QOE	Qendra Operative Emergjente
QPKS	Qendra për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjeve
SDC/DEMOS	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SIDA	Agjensioni Suedez për Zhvillim Ndërkombëtar
SMFK	Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale
SVL	Strategjia për Vetëqeverisje Lokale
SHE	Shtabet Emergjente
SZHEL	Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
USAID	Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik

HYRJE

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në përputhje me mandatin e saj ligjor, objektivat e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016–2026, si dhe Planin Vjetor të Punës për vitin 2024, ka realizuar aktivitetet e planifikuara për periudhën Janar – Dhjetor 2025. Raporti pasqyron arritjet sipas fushave të përcaktuara në këtë plan, të integruara edhe në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim. Aktivitetet e raportuara zënë vend në kuadër objektivave kryesore të punës, si vijon:

- Rritja e zhvillimit ekonomik lokal përmes mbështetjes financiare të komunave të bazuar në performancë;
- Avancimi i bashkëpunimit ndërkomunal, ndërkombëtar dhe ndërkufitar të komunave;
- Avancimi i politikave dhe i kornizës ligjore për vetëqeverisjen lokale;
- Promovimi i qeverisjes së mirë, rritja e transparencës komunale, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe zhvillimi i kapaciteteve institucionale;
- Avancimi i qeverisjes së hapur dhe i shërbimeve digjitale në nivel lokal;
- Administrata, shërbimet e përgjithshme, financat, auditimi dhe prokurimi;

Raporti bazohet në të dhënat e raportuara për aktivitetet e realizuara nga departamentet dhe njësitë/divizionet e MAPL-së, respektivisht:

- Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik Lokal
- Departamenti për Demokraci Lokale dhe Bashkëpunim Ndër-komunal
- Departamenti për Qeverisje të Mirë në Nivel Lokal
- Departamenti për Digjitalizim të Shërbimeve në Komuna
- Departamenti për Mbikëqyrje dhe Performancë Lokale
- Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave
- Departamenti për Bashkëpunim Ndërkufitar dhe Komunal Ndërkombëtar
- Departamenti Ligjor
- Departamenti për Shërbime të Përgjithshme
- Divizioni për Buxhet dhe Financa
- Njësia për Auditim të Brendshëm
- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Divizioni i Prokurimit
- Divizioni për Komunikim Publik

Lidhur me metodologjinë e raportit, si bazë janë përdorur të dhënat e siguruara nga njësitë përkatëse të MAPL-së, të cilat janë grumbulluar, analizuar dhe sistemuar në përputhje me objektivat strategjike dhe aktivitetet e përcaktuara në planin vjetor të punës. Raporti mbështetet në indikatorë sasiorë dhe cilësorë, të cilët reflektojnë nivelin e realizimit të aktiviteteve.

Periudha e raportimit përfshin kohën nga janari deri në dhjetor 2025, duke ofruar një pasqyrë të plotë të rezultateve të arritura gjatë vitit.

Raporti përshkruan aktivitetet e të gjitha njësive organizative të MAPL-së duke u fokusuar në fushat kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së ministrisë sipas planit vjetor të punës për vitin 2025.

Raporti është hartuar nga Divizioni për Koordinim të Politikave, në kuadër të Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave.

Saktësia e të dhënave është përgjegjësi e departamenteve dhe njësive organizative të MAPL-së, të përcaktuara me Rregulloren (ZKM) Nr. 17/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet e përkushtuar që të forcohet dhe konsolidohet qeverisja lokale, të forcohet aftësia e komunave që nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe përfaqësimit demokratik, të ofrohen shërbime publike me kosto efektive për të rritur cilësinë e jetës, sigurinë dhe ekonominë lokale.

I. RITJA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL PËRMES MBËSHTETJES FINANCIARE TË KOMUNAVE TË BAZUAR NË PERFORMANCË

Aktivitetet e realizuara në kuadër të këtij objekti, janë grupuar në 3 fusha kryesore si vijon:

- Hartimit të politikave për zhvillim ekonomik lokal;
- Financimit të projekteve të komunave;
- Menaxhimi i performancës komunale;

1.1. Zhvillimi i Kuadrit Strategjik për Zhvillim Ekonomik Lokal

Zhvillimi ekonomik lokal është një proces që synon përmirësimin e jetës së qytetarëve, duke nxitur rritjen e investimeve, duke stimuluar ndërmarrjet me potencial zhvillimi, duke promovuar krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe duke ngritur infrastrukturën e nevojshme për lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve. Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës, nën udhëheqjen e MAPL-së dhe në bashkëpunim me institucionet e tjera të linjës, komunat dhe akterët e tjerë relevantë, ka hartuar Programin Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030, me qëllim të lokalizimit të orientimeve strategjike që rrjedhin nga SKZH-ja dhe PKZH 2030, si dhe nga strategjitë sektoriale që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik.

Ndërsa për zbatimin e Programit Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2023-2030, komiteti zbatues i PNZHEL, ka mbajtur takimin e radhës, me ç ‘rast janë diskutuar përgjegjësitë dhe sfidat e institucioneve bartëse për zbatimin e masave të përcaktuara. Në këtë kuadër, është realizuar takimi edhe me drejtorët komunal për zhvillim ekonomik lokal për obligimet e dala nga PNZHEL.

Sa i përket hartimit të Strategjive për Zhvillim Ekonomik Lokal në komuna, në aspektin profesional janë mbështetur komunat: *Lipjan, Kamenicë, Hani i Elezit, Fushë Kosovë, Prizren dhe Gjilan*, në procesin e hartimit të Strategjive për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe harmonizimin e tyre me PNZHEL 20230.

Për mbështetjen e komunave në procese buxhetore, është përgatitur shkresa për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me rekomandimet në procesin e përcaktimit të financimit komunal nga Komisioni i Granteve sipas LFPL dhe LMFPF.



Është hartuar raporti i shpenzimeve të komunave për vitin 2025



Është hartuar raporti i të hyrave vetanake të komunave për vitin 2025



Raporti lidhur me zbatimin e Programit Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030

Gjithashtu është hartuar edhe Raporti vjetor lidhur me opinionin e auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2024.

1.2.Financimi i Projekteve të Komunave

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuadër të investimeve kapitale ka tri programe:

- Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër-komunal,
- Programi mbështetja për projektet infrastrukturore për komunitete në Komunitet e Republikës së Kosovës,
- Bashkëfinancimi me donator për skemën e granteve të bazuar në performancës komunale.

Programet për financimin e projekteve kapitale të komunave janë një ndër instrumentet kryesore të mbështetjes direkte të komunave në fushën e zhvillimit ekonomik. Për programin komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër-komunal, dhe programin për mbështetje për projektet infrastrukturore për komunitete në Komunitet e Republikës së Kosovës, MAPL ka përgatitur kriteret për financim të projekteve të komunave.

Është lansuar fondi prej 150,000.00 € për financimin e projekteve. Në kuadër të kësaj thirrjeje janë pranuar aplikime nga tri komuna, me gjithsej katër projekte. Projektet janë vlerësuar nga komisioni përkatës, është hartuar raporti i vlerësimit dhe është bërë njoftimi për komunën përfituese, e cila ka fituar mbështetje për dy projekte.

Me datë 24.02.2025 janë nënshkruar marrëveshjet për financimin e projekteve me komunën e Pejës dhe në kuadër të kësaj çështjeje është mbajtur punëtorja me menaxheret e projekteve lidhur me implementimin e projekteve, poashtu janë realizuar takime teknike me komunën e Pejës për projektet e financuara nga MAPL, si dhe në vazhdimësi janë realizuar vizitat në terren për verifikimin e progresit të punimeve bazuar në situacionet e pranuar për pagesë.

Në kuadër të bashkëfinancimit me donatorë për skemën e granteve bazuar në performancën komunale, është koordinuar procesi i projekteve me komunat përfituese lidhur me projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale për fondet e MAPL-se, si dhe është dërguar lënda e kompletuar me 24 projekte në MFPT për opinion financiar dhe është pranuar opinionin pozitiv nga MFPT. Ndërsa marrja e vendimit të Qeverisë për rialokimin e mjeteve është bërë më datën 29.05.2025. Zotimi për ndarjen e mjeteve financiare është përgatitur. Janë realizuar takimet me komunat përfituese për projektet detaje, është mbajtur punëtorja me menaxherët e projekteve lidhur me procesin e implementimit të projekteve, poashtu janë realizuar vizitat në terren për 24 projekte.

Është përgatitur informata lidhur me financimin e projekteve për palët e treta - qasje në dokumente publike si dhe është dërguar raporti i progresit të projekteve tek menaxhmenti. Si dhe janë hartuar raportet e investimeve kapitale si në vijim:



Raporti vjetor përmbledhës i investimeve kapitale për projekte për vitin 2025



Raporti për investime kapitale në komuna për periudhën 2008-2024



Raporti për investime kapitale në komuna për periudhën 2022-2024

1.3.Vlerësimi i Performancës Komunale

Rëndësi e veçantë i është kushtuar avancimit të sistemit të performancës komunale, si dhe përmirësimit të skemës së grantit të bazuar në performancë, me qëllim rritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies në qeverisjen lokale.

Sa i përket matjes së performancës së komunave për periudhën Janar-Dhjetor 2024, me datën 5 maj 2025 është hapur thirrja për raportim të performancës komunale për vitin 2024 dhe njëherësh të gjitha komunat janë njoftuar lidhur me procesin e raportimit të performancës komunale, proces i cili ka ndikim në rritjen e cilësisë së shërbimeve të komunës përmes kësaj matje.

Pas pranimit të të dhënave nga komunat, është bërë përpunimi dhe verifikimi i tyre. Në fund të këtij procesi është hartuar dhe finalizuar Raportit i Performancës Komunale 2024, i cili është bërë publik më datën 16 tetor 2025, i cili ka pasqyruar rezultatet e punës së komunave në 16 fusha, të vlerësuara përmes treguesve të Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale. Vlerësimi është bërë në bashkëpunim me zyrtarët komunalë, duke konsultuar përpara procesit të matjes për treguesit e mundshëm dhe pezulluar disa prej tyre. Raporti është hartuar dhe vlerësuar përmes Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Performancës Komunale, duke përfshirë dokumentet referuese të të dhënave të raportuara. Ndërsa, Raporti i Grantit të Performancës Komunale mbetet ende në proces të hartimit.

Gjithashtu, janë mbajtur takime, trajnime dhe punëtori me komuna për promovimin e politikave të GPK-së.

Gjatë kësaj periudhe është hartuar metodologjia për auditim social të GPK-së, gjatë fazës fillestare, ku janë trajnuar organizatat e shoqërisë civile me qëllim të rritjes së kapaciteteve të tyre, për të kuptuar më mirë procesin e qeverisjes lokale në Kosovë, si dhe përvetësimin e procesit të auditimit social në komuna.

Auditimi social ka rezultuar një mekanizëm efektiv për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, duke mundësuar monitorimin e zbatimit të projekteve në faza të ndryshme të implementimit të tyre përmes përfshirjes aktive të qytetarëve, i cili u realizua në komunat; Prizren, Junik, Suharekë, Partesh, Klinë, Mitrovicë e Jugut, Kaçanik, Istog, Drenas, Dragash, Lipjan dhe Mamushë.

Ky proces ka krijuar hapësirë për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të qytetarëve jo vetëm në monitorim, por edhe në fazat e dizajnit dhe zbatimit të projekteve kapitale që financohen nga granti performancës në **33 projekte në total**. Qytetarët kanë kontribuar në identifikimin e nevojave reale të komunitetit, kanë adresuar çështje konkrete gjatë implementimit dhe kanë ofruar rekomandime që kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë së projekteve. Kjo qasje ka ndihmuar që projektet kapitale të jenë më funksionale, më gjithëpërfshirëse dhe më të orientuara drejt interesit publik, duke siguruar që investimet të jenë në shërbim të drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe në përputhje me prioritetet lokale.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal konform mandatit ligjor të përcaktuar me legjislacionin për vetëqeverisje lokale monitoron komunat mbi bazën e të cilave harton raporte periodike për funksionimin e komunave të Republikës së Kosovës. Komunat, përkatësisht organet e komunës janë të obliguara që ushtrimin e kompetencave të tyre ta zhvillojnë sipas Kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore të Republikës së Kosovës. Në periudhën Janar – Dhjetor 2025, kanë funksionuar kuvendet në 38 komuna të Republikës së Kosovës, duke mbajtur mbledhje rregullisht. Kuvendet e komunave kanë mbajtur gjithsej **430 mbledhje**. Prej tyre, të rregullta kanë qenë 325, të jashtëzakonshme 43, solemne 55 dhe urgjente 7. Në kuadër të departamentit për Mbikëqyrje dhe Performancë Lokale, mbledhjet e kuvendeve të komunave janë monitoruar përmes sistemit të teleprezencës, si dhe prezencës fizike të zyrtarëve sipas nevojës, poashtu janë hartuar katër raporte periodike të monitorimit të seancave të kuvendeve komunale.

II. AVANCIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL, KOMUNAL NDËRKOMBËTAR DHE NDËRKUFITAR

Aktivitetet në këtë objektiv janë realizuar në drejtim të:

- Forcimit të bashkëpunimit ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar;
- Zbatimit të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar;

2.1. Bashkëpunimi komunal ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal gjatë vitit 2025 ka vazhduar angazhimin në nxitjen, monitorimin dhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale me qëllim të krijimit të një mjedisi të favorshëm për zhvillimin dhe avancimin e bashkëpunimit ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka vazhduar aktivitetet lidhur me mbështetjen e komunave për bashkëpunim ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar për vitin 2024, për çka ka mbajtur 4 takime me donatorë për mbështetje të aktiviteteve. Në kuadër të **bashkëpunimit ndërkomunal**, gjatë kësaj periudhe janë realizuar 2 takime me donatorë për mbështetje të aktiviteteve, si dhe 5 vizita në komunat Skenderaj, Ferizaj, Mitrovicë e Jugut, Drenas dhe Malishevë, me qëllim të nxitjes dhe promovimit të bashkëpunimit ndërkomunal, si dhe janë organizuar takime dedikuar procesit të planifikimit të përbashkët për hartimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturave, me qëllim të koordinimit dhe

harmonizimit të veprimeve të komunave pjesëmarrëse në këtë fushë, ndërsa nuk është arritur nënshkrimi i ndonjë marrëveshjeje të re.

Sa i përket **bashkëpunimit komunal ndërkombëtar**, gjatë periudhës raportuese janë pranuar iniciativa për bashkëpunim komunal ndërkombëtar nga komunat e Republikës së Kosovës, të cilat janë shqyrtuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat institucionale që rregullojnë këtë fushë. Si rezultat i këtyre proceseve, dy (2) iniciativa kanë përfunduar me nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar ndërmjet komunave. Në këtë kuadër, janë përgatitur raportet përkatëse për iniciativat dhe marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe janë shqyrtuar dhe vlerësuar dy (2) vendime lidhur me ligjshmërinë e nismave dhe marrëveshjeve për bashkëpunim komunal ndërkombëtar.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet **Komunës së Podujevës, Kosovë** dhe **City of Ames, Iowa, SHBA**, në fushat e bujqësisë, arsimit, kulturës, rinisë, sportit, bashkëpunimit institucional, zhvillimit ekonomik dhe të biznesit, strehimit social, si dhe shkëmbimit të vizitave ndërmjet përfaqësuesve të palëve. Po ashtu, është realizuar marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet **Komunës së Klinës, Kosovë** dhe **Treviso, Itali**, në fushat e shëndetësisë, arsimit, kulturës, rinisë, sportit, zhvillimit ekonomik dhe turizmit.

Përveç iniciativave që kanë rezultuar me nënshkrimin e marrëveshjeve, gjatë periudhës raportuese Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar dhe trajtuar edhe një numër iniciativash të tjera të paraqitura nga komunat e Republikës së Kosovës për vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar me qytete dhe komuna nga shtete të ndryshme. Në total janë evidentuar **12 iniciativa për bashkëpunim komunal ndërkombëtar** të cilat nuk kanë rezultuar ende me nënshkrimin e marrëveshjeve formale të bashkëpunimit. Këto iniciativa synojnë krijimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet komunave, si dhe shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira në fusha të ndryshme të qeverisjes lokale. Fushat e propozuara të bashkëpunimit përfshijnë, ndër të tjera, arsimin, kulturën, turizmin, zhvillimin ekonomik lokal, shërbimet publike, mbrojtjen e mjedisit, rininë dhe sportin, si dhe bashkëpunimin institucional ndërmjet komunave partnere.

Në kuadër të aktiviteteve të kësaj fushe, gjatë periudhës raportuese janë hartuar katër (4) raporte periodike për bashkëpunimin komunal ndërkombëtar. Njëkohësisht, databaza me të dhënat për bashkëpunimet komunale ndërkombëtare është përditësuar në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim të sigurimit të evidencës së plotë dhe monitorimit sistematik të zhvillimeve në këtë fushë.

Gjithashtu, janë realizuar dy (2) takime me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, të cilat janë fokusuar në avancimin e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar dhe në nxitjen e binjakëzimeve ndërmjet komunave të Republika e Kosovës dhe qyteteve apo komunave të vendeve të tjera. Këto takime kanë kontribuar në forcimin e bashkëpunimit institucional dhe në avancimin e koordinimit ndër-institucional në fushën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar.

2.2. Zbatimi i Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar

Në fokus ishte sigurimi i një zbatimi efikas, efektiv dhe transparent të projekteve të zbatuara në kuadër të tri programeve të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë, Shqipëri – Kosovë dhe Kosovë – Maqedoni e Veriut, më ç’ rast janë realizuar **6 vizita monitoruese (Shqipëri–Kosovë), 4 vizita monitoruese (Kosovë–Maqedoni e Veriut) dhe 1 vizitë monitoruese (Mali i Zi–Kosovë).**

Menaxhimi i Kontratës së Grantit për Asistencë Teknike në kuadër të tri programeve të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë, Shqipëri – Kosovë dhe Kosovë – Maqedoni e Veriut

Programi IPA III Shqipëri- Kosovë - Në kuadër të këtij programi janë përfunduar aktivitetet si:

- Është mbajtur një (1) takim bilateral në mes të Strukturave Operative të programit,
- Janë mbajtur dy (2) takime të Komitetit të Përbashkët Monitorues,
- Raporti Vjetor i Zbatimit (AIR) të programit të BNK-së për vitin 2024 i cili është miratuar nga Komiteti i Përbashkët Monitoruese,
- Plani vjetor i hartuar dhe miratuar nga Komiteti i Përbashkët Teknik,
- Hartimi i Marrëveshjes së Partneritetit për definim të përgjegjësive në mes të Strukturave të BNK-së,
- Plani vjetor i Komunikimit dhe Vizibilitetit i cili është miratuar nga Komiteti i Përbashkët Teknik,
- Hartimi i raportit financiar dhe narrativ për zbatim të programit.

Programi IPA III Kosovë-Maqedoni e Veriut- Në kuadër të këtij programi janë përfunduar aktivitetet si:

- Janë mbajtur katër (4) takimeve bilaterale/teknike koordinuese në mes të Strukturave Operative të programit,
- Është mbajtur një (1) takim i Komitetit të Përbashkët Monitorues,
- Raporti Vjetor i Zbatimit (AIR) të programit të BNK-së për vitin 2024 i cili është miratuar nga Komiteti i Përbashkët Monitoruese,
- Plani vjetor i hartuar dhe miratuar nga Komiteti i Përbashkët Teknik,
- Hartimi i Marrëveshjes së Partneritetit për definim të përgjegjësive në mes të Strukturave të BNK-së,
- Plani vjetor i Komunikimit dhe Vizibilitetit i cili është miratuar nga Komiteti i Përbashkët Teknik,
- Hartimi i raportit financiar dhe narrativ për zbatim të programit.

Programi IPA III Mali i Zi- Kosovë Në kuadër të këtij programi janë përfunduar aktivitetet si:

- Janë mbajtur dy (2) takime bilaterale në mes të Strukturave Operative të programit,
- Hartimi i 12 raporteve mujore për zbatim të Kontratës për Asistencë Teknike,
- Realizimi i një (1) takimi të Komitetit të Përbashkët Drejtues dhe 3 të tjera me procedura me shkrim,

- Raporti Vjetor i Zbatimit (AIR) të programit të BNK-së për vitin 2024 i cili është miratuar nga Komiteti i Përbashkët Monitoruese,
- Plani vjetor i hartuar dhe miratuar nga Komiteti i Përbashkët Teknik,
- Përgatitja e dy (2) raporte gjashtëmujore lidhur me menaxhimin e rrezikut në kuadër të zbatimit të programit (plani i veprimit, forma e raportimit, regjistri i rreziqeve),
- Plani vjetor i Komunikimit dhe Vizibilitetit i cili është miratuar nga Komiteti i Përbashkët Teknik,
- Përgatitja e deklaratave vjetore, vetëpyetësorit dhe listës kontrolluese që garanton zbatimin efikas të programit të BNK-së Mali i Zi – Kosovë dhe dërgimi tek struktura e BNK-së në Mal të Zi,
- Raporti (follow up) për Grupin e Auditorëve të programit lidhur me realizimin e rekomandimeve është plotësuar dhe dorëzuar,
- Hartimi i raportit financiar dhe narrativ për zbatim të programit.

Poashtu në kuadër të tri programeve:

- Është mbajtur një (1) takim në mes MAPL, NIPAC dhe Zyrën e BE-së lidhur me progresin e arritur në kuadër të tri programeve të BNK-së, si dhe
- Është mbajtur forumi rajonal për diskutimin e progresit të arritur dhe sfidave në kuadër të tri programeve të bashkëpunimit ndërkomunal në nivel rajonal.

Menaxhimi i thirrjeve për propozime në kuadër të tri programeve të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë, Shqipëri – Kosovë dhe Kosovë – Maqedoni e Veriut

- ✓ ***Programi IPA III Shqipëri-Kosovë*** - Në kuadër të këtij programi është shpallur thirrja e për projekt propozime, ku në kuadër të kësaj thirrjeje janë organizuar 3 sesione informative (1 në Lezhë, 1 në Prizren dhe 1 online) dhe 3 forume për gjetjen e partnerëve. Shuma totale e thirrjes është 5,280,00.00 euro, ndërsa prioritetet tematike të thirrjes janë: *Mbrojtja e ambientit, adaptimi dhe zbutja e ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve dhe Nxitja e turizmit të qëndrueshëm në rajonin ndërkufitar dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore*. Aktualisht, në kuadër të këtij programi është duke u zhvilluar vlerësimi i aplikacioneve të plota.
- ✓ ***Programi IPA III Kosovë-Maqedoni e Veriut*** - Në kuadër të këtij programi është shpallur thirrja e parë për projekt propozime, ku në kuadër të kësaj thirrjeje janë organizuar 2 sesione informative dhe 2 sesione për gjetjen e partnerëve. Shuma totale e thirrjes është 3,240,00.00 euro, ndërsa prioritetet tematike të thirrjes janë: *Mbrojtja e ambientit, adaptimi dhe zbutja e ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve dhe Konkurrueshmëria, mjedisi i biznesit, dhe zhvillimi i MSME-ve, tregtisë dhe investimeve*. Aktualisht, në kuadër të këtij programi projektet janë në fazën finale të vlerësimit dhe pritet të kontraktohen në tremujorin e parë.
- ✓ ***Programi IPA III Kosovë-Mali i Zi*** - Në kuadër të këtij programi është shpallur thirrja e parë për Projekt Propozime (CfP). Shuma totale e thirrjes është 5,400,000.00 euro, ndërsa prioritetet tematike të thirrjes janë: *Rritja e punësimit të të rinjve dhe personave të*

margjinalizuara në rajonin ndërkufitar dhe Nxitja e turizmit të qëndrueshëm në rajonin ndërkufitar. Aktualisht, në kuadër të këtij programi projektet janë në fazën finale të vlerësimit dhe pritet të kontraktohen në tremujorin e dytë.

Në kuadër të këtij programi është realizuar vizita e përbashkët studimore në Pragë e përbërë nga tri delegacione të strukturave të BNK-së (Kosovë, Shqipëri dhe Mali i Zi), me qëllim të forcimit të kapaciteteve të strukturave të BNK-së dhe stafit të SPT-së, krijimit të rrjeteve të reja të bashkëpunimit, kapitalizimit të projekteve, si dhe prezantimit të projekteve të zbatuara në kuadër të programeve të tjera të bashkëpunimit ndërkufitar dhe të lidhjes ndërmjet makro-strategjive dhe programeve Interreg.

2.3. Kontrolli i programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar

Për kontrollin dhe verifikimin financiar të fondeve të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar, në përputhje me rregullat dhe standardet e BE-së dhe ligjet e aplikueshme vendore janë përgatitur dhe aprovuar 2 plane të përditësuara lidhur me orarin e realizimit të vizitave OTSV on the spot check, dhe të njëjtat janë ndarë me Drejtorinë për Financa dhe Kontraktim të Fondeve të BE-së në Ministrinë e Financave të Malit të Zi – CFCU. Plani vjetor i OTSV përditësohet të paktën një herë në tremujor (nëse projektet bëjnë kërkesë për shtyrje të afatit të implementimit të projektit ose shtyrje të afatit të dorëzimit të raportit final narrativ dhe financiar).

Gjatë periudhës raportuese janë pranuar nëntë (9) raporte finale të projekteve, është bërë verifikimi i shpenzimeve, poashtu janë plotësuar raportet e verifikimit administrativ për secilin projekt final të pranuar dhe janë dërguar kërkesat për informata shpeshë aty ku ka qenë e nevojshme. Për secilin projekt është krijuar një databazë fizike dhe elektronike. Ndërsa janë lëshuar gjithsej 7 konfirmime (1 konfirmim nga thirrja e II-të dhe 6 konfirmime nga thirrja e III-të) për shpenzimet e pranueshme dhe të pa pranueshme për përfituesit nga Kosova tek Autoriteti Kontraktues. Poashtu 11 Databaza janë përgatitur sa i përket afateve të raportimit për secilën kontratë të përfituesve të grantit CBC – MNG -KS (IPA III) - thirrja e III. Gjithashtu janë realizuar 8 vizita në terren tek projektet e thirrjes.

Janë finalizuar dhe janë dërguar në CFCU garancioni vjetor Menaxhues dhe vetë-pyetëtori me dokumentet të tjera shoqëruese për vitin 2025.

Poashtu janë përcjellë në CFCU 2 raporte për Menaxhim të Rrezikut mbi rrezikun të mundshëm të paraqitur nga zyrtari për menaxhim të rrezikut nga Divizioni për Kontroll Financiar të Programeve të Bashkëpunimit ndërkufitar, siç janë të parapara me dokumentin e programit PLCP: *Risk Alert Form, Risk Action Plan, Risk Register*, si dhe janë siguruar informatat e kërkuara për Auditorin e jashtëm në kuadër të kontrollit të programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar.

III. AVANCIMI I POLITIKAVE DHE I KORNIZËS LIGJORE PËR VETËQEVERISJEN LOKALE

Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe që ndërlidhen me përmbushjen e këtij objektivi të Planit të Punës për vitin 2025, janë shtrirë në drejtim të:


- Hartimit të projektligjeve dhe akteve nënligjore të planifikuara,
- Konsultimit paraprak të akteve sektoriale,
- Takimeve të rregullta me komunat.
- Monitorimit të komunave;
- Adresimin dhe zbatimin e obligimeve nga agjenda evropiane;
- Koordinimit të politikave;
- Raporteve të hartuara.

3.1. Zhvillimi i Akteve Ligjore dhe Nënligjore

Gjatë vitit 2025, Departamenti Ligjor ka ushtruar rolin e tij në përputhje me mandatin dhe përgjegjësitë e përcaktuara ligjore, duke kontribuar në mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në fuqi nga komunat, zhvillimin e legjislacionit në fushën e vetëqeverisjes lokale, si dhe në garantimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së Ministrisë me kornizën ligjore në fuqi. Veprimtaria e Departamentit është fokusuar në forcimin e ligjshmërisë, transparencës dhe koordinimit institucional në nivel qendror dhe lokal.

Në kuadër të planit vjetor të punës, Departamenti Ligjor ka planifikuar **gjashtë objektiva operacionale**, të cilat janë zbatuar përmes një sërë aktivitetesh konkrete. Për vitin raportues janë gjithsej **25 aktivitete**, nga të cilat **20 janë realizuar plotësisht**, ndërsa **5 aktivitete** kanë mbetur në proces të zbatimit dhe pritet të përfundojnë në periudhën vijuese.

Një pjesë e konsiderueshme e angazhimit të Departamentit i është kushtuar vlerësimit të ligjshmërisë së akteve të kuvendeve komunale, ku janë pranuar dhe shqyrtuar rreth **1478 akte**, prej tyre 54 rregullore dhe 1424 vendime, e mbi bazën e tyre janë hartuar **12 raporte mujore për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të komunave**.



Këto aktivitete kanë kontribuar në rritjen e nivelit të përgjegjshmërisë së komunave dhe në përmirësimin e cilësisë së akteve komunale. Paralelisht, janë përgatitur dhe dorëzuar **dy raporte** për vlerësimin e ligjshmërisë për ministritë e linjës.

Janë zhvilluar edhe **katër takime të rregullta** me Kryesues të Kuvendeve, me drejtorë të administratës dhe zyrtarë të tjerë.

Departamenti Ligjor ka ndërmarrë veprime konkrete për zhvillimin e legjislacionit në fushën e vetëqeverisjes lokale, përmes themelimit të grupeve punuese, zhvillimit të konsultimeve paraprake dhe publike, si dhe hartimit të akteve rregullative.

Një rol i rëndësishëm, ka luajtur edhe në procesin e harmonizimit të projektligjeve dhe akteve nënligjore sektoriale në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, përmes shqyrtimit të koncept-dokumenteve dhe akteve të pranuar nga ministritë e linjës, dhënies së komenteve përkatëse dhe koordinimit të brendshëm institucional. Po ashtu, departamenti ka siguruar raportimin e rregullt në Zyrën e Kryeministrit për aktet e miratuara nga Ministria, duke mundur edhe publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare. Po ashtu, gjatë vitit janë hartuar tabela për koncept-dokumente, projektligje dhe akte nënligjore, duke mundur një pasqyrim të strukturuar të komenteve dhe vërejtjeve ligjore. Të gjitha aktivitetet janë realizuar në përputhje me planin vjetor të punës dhe kompetencat e Departamentit Ligjor.

Nën kompetencat e tij, departamenti ka realizuar edhe harmonizimin e akteve **(1)**, që kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale me legjislacionin e Bashkimit Evropian, në bashkëpunim të vazhdueshëm me ministritë e linjës.

Në kuadër të zbatimit të legjislacionit dhe mbështetjes së komunave, Departamenti Ligjor ka ofruar këshillim dhe shpjegime ligjore, ka kundërshtuar lëndë në gjykatat kompetente kur Ministria ka qenë palë në procedurë, në **18** prej tyre, si dhe ka hartuar dokumente udhëzuese si **Hartimi i Doracakut** për përgjegjësitë e komunave që derivojnë nga aktet ligjore të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe aktet nënligjore të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministrit sektoriale, që lehtësojnë zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2025 janë pranuar dhe shqyrtuar 5 kërkesa për konsultim paraparak. Ndërsa, lidhur me shkresat njoftuese që adresohen në komuna, në këtë periudhë kohore janë pranuar dhe shqyrtuar 97 kërkesa dhe 15 ankesa nga personat fizik dhe juridik.



3.2. Vlerësimi i Ndikimit të Politikave në Fushën e Vetëqeverisjes Lokale

Veprimtaria e Departamentit Ligjor gjatë vitit 2025, ka kontribuar në forcimin e sundimit të ligjit në nivel lokal, përmirësimin e kornizës ligjore dhe rritjen e kapaciteteve institucionale për zbatimin e legjislacionit të vetëqeverisjes lokale, duke krijuar bazë të qëndrueshme për përmbushjen e objektivave në vitet në vijim. Dokumentet kryesore që e kategorizuan ndikimin në nivel lokal janë;

- Hartimi i Draftit-Rregullorës për Shqyrtimin Administrativ te Akteve Komunale.
- Hartimi i Draftit-Rregullorës për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale.
- Hartimi i Doracakut për përgjegjësitë e komunave që derivojnë nga aktet ligjore të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe aktet nënligjore të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministrsit sektoriale.

3.3. Adresimi i Obligimeve nga Agjenda Evropiane

Roli i komunave në përmbushjen e obligimeve nga agjenda evropiane është jashtëzakonisht i rëndësishëm në këtë proces. Një numër i lartë i prioriteteve të MSA-së janë nën përgjegjësinë dhe kompetencat e nivelit komunal, për çka Komisioni Evropian çdo vit i kushton rëndësi të veçantë theksimit të arriturve dhe sfidave të komunave në raportin e KE-së për vendin.

Lidhur me këtë proces Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka bërë koordinimin e aktiviteteve me komuna për adresimin dhe zbatimin e obligimeve të cilat burojnë nga agjenda e

integritimit evropian. Në kuadër të objektivës *Menaxhimi i procesit të planifikimit dhe monitorimit të Agjendës Evropiane*, është hartuar *Raporti i përmbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar-Qershor 2025, si dhe Janar- Dhjetor 2025*. Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin përafërsisht **64.2%** të aktiviteteve të planifikuara në fushën e kriterëve politike, përafërsisht **71.3%** të aktiviteteve të planifikuara në fushën e kriterëve ekonomike, si dhe përafërsisht **65%** aktiviteteve të planifikuara në fushën e standardeve evropiane. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për periudhën Janar - Dhjetor 2025 është **67%**.

Për të realizuar aktivitetet e agjendës evropiane, janë mbajtur takime me donatorë për procesin e integritimit Evropian. Në bashkëpunim me OSBE është mbajtur një takim i përbashkët me Zyrtarët Komunal për Integritime Evropiane, me qëllim të rishikimit të Planit të përgjithshëm të përmbushjes së Obligimeve nga Agjenda Evropiane. Në kuadër të zbatimit të planit të punës, është realizuar një seri vizitash në 9 komuna (Drenas, Ferizaj, Fushë Kosovë, Junik, Lipjan, Mitrovicë e Jugut, Shtime, Skenderaj dhe Vushtrri), me qëllim të rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit në fushën e integritimit evropian në nivelin lokal, duke ofruar mbështetje dhe shkëmbim informacioni për avancimin e këtij procesi.

Gjatë kësaj periudhe raportuese është përgatitur Raporti i masave të MAPL-së mbi Zbatimin e Programit Kombëtar të Integritimeve Evropiane për vitin 2025. Gjithashtu, janë identifikuar dhe propozuar Obligimet e komunave dhe MAPL-së nga PKZMSA, dhe është përgatitur Inputi i MAPL-së për raportin e KE-së për Kosovën – 2024, për periudhën 1 shtator 2024 – 31 mars 2025 dhe për periudhën 1 prill – 31 gusht 2025.

Në veçanti, është raportuar edhe për zbatimin e **Planit të Integritetit të MAPL-së për periudhën janar-dhjetor 2025**. Veprimet të cilat janë të pasqyruara në kuadër të këtij plani, ritheksojnë përkushtimin e Ministrisë për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet brenda fushëveprimit të saj. Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të institucionit dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

3.4. Koordinimi i Politikave

Gjatë kësaj periudhe i është kushtuar shumë rëndësi zhvillimit të politikave të planit të punës së MAPL-së dhe Programit Kombëtar për Zhvillim. Për implementimin e duhur të këtyre politikave në vazhdimësi janë zhvilluar takime me departamente dhe njësitë organizative të MAPL-së për koordinimin e aktiviteteve, me ç' rast është përfunduar hartimi i planit vjetor të punës së MAPL-së për vitin 2026.

Në kuadër të Programit Kombëtar për Zhvillim 2025-2027, është përgatitur raporti i zbatimit të aktiviteteve të MAPL-së për periudhën Janar-Dhjetor 2025, gjithashtu është hartuar edhe raporti vjetor për vitin 2024. Gjatë kësaj periudhe janë hartuar edhe dokumente të tjera, si:



Raporti vjetor i punës së MAPL-së për vitin 2024



Raporti i zbatimit të planit të punës për periudhën Janar-Qershor 2025



Plani Institucional i MAPL-së për vitin 2025-2027



Raporti vjetor i funksionimit të komunave Janar – Dhjetor 2024



Raportimi për Planin Kombëtar për Zhvillim në baza periodike (3 mujore), si dhe për periudhën Janar - Dhjetor 2025

Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe është hartuar edhe **Raporti Vjetor për zbatimin e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016–2026**, i cili pasqyron progresin dhe nivelin e realizimit të objektivave strategjike për vitin 2024.

IV. PROMOVIMI I QEVERISJES SË MIRË, RITJJA E TRANSPARENCËS KOMUNALE, MBROJTJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE ZHVILLIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE

Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe (Janar – Dhjetor, 2025) janë ato të cilat ndërlidhen me:

- Transparencën komunale;
- Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut
- Zhvillimin e kapaciteteve institucionale

4.1. Transparenca dhe Llogaridhënia Komunale

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka monitoruar dhe vlerësuar transparencën komunale në zbatimin e obligimeve ligjore për publikimin e akteve dhe informatave zyrtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë.

Në mënyrë të rregullt edhe gjatë vitit 2025 është vazhduar me vlerësimin e transparencës komunale, përfshirë monitorimin e kuvendeve të komunave në aspektin e transparencës, monitorimin e ekzekutivit dhe llogaridhënia në aspektin e transparencës, monitorimin e transparencës buxhetore të komunave, transparenca në prokurimin publik, monitorimi i takimeve publike me qytetarët dhe konsultimin publik.

Ky proces është realizuar përmes monitorimit të ueb-faqeve zyrtare të 38 komunave, lidhur me publikimin e akteve dhe dokumenteve zyrtare. Në këtë kuadër, është hartuar dhe finalizuar **Raporti Vjetor për Vlerësimin e Transparencës së Komunave**, i bazuar në të dhënat e mbledhura gjatë procesit të monitorimit. Raporti përfshin gjithashtu edhe një analizë krahasuese me raportin e vitit paraprak, me qëllim identifikimin e progresit të arritur si dhe të mangësive në fushën e transparencës komunale. Raporti është prezantuar në një takim zyrtar, në prani të zyrtarëve përgjegjës raportues dhe përfaqësuesve të Asociacionit të Komunave. AI, gjithashtu është publikuar në ueb-faqen zyrtare të MAPL-së, duke siguruar qasje të hapur për publikun. Raporti shërben si bazë vjetore për vlerësimin e përmbushjes së obligimeve ligjore nga komunat, në përputhje me Udhëzimin Administrativ për Administratën e Hapur, si dhe orientimin e masave për përmirësimin e qeverisjes së hapur në nivel lokal.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal rëndësi të veçantë i ka dedikuar fuqizimit të komunave në hartimin e politikave për pjesëmarrjen e qytetarëve në zhvillimin e politikave lokale, në;

- ❖ Konsultimi paraprak me komuna dhe mbështetja e tyre në hartimin e dokumenteve në fushën e transparencës,
- ❖ Hartimi i model-raportit për konsultime publike dhe ri dërgimi i tij në komuna, si obligim ligjor i përcaktuar me Udhëzimin Administrativ për Administratën e Hapur,
- ❖ Ofrimi i këshillave profesionale për komunat në zbatimin e buxhetimit me pjesëmarrje, bazuar në Manualin për Buxhetim me Pjesëmarrje,
- ❖ Ofrimi i opinioneve ligjore lidhur me hartimin e Rregullores për transparencë, Model Planet e Veprimit për Transparencë dhe Planeve Komunale për Komunikim me Publikun.

Në kuadër të përpjekjeve për avancimin e transparencës komunale në zbatimin e plotë të dispozitave ligjore, në bashkëpunim me komunat dhe OSBE-në, janë organizuar **katër (4) takime bashkëpunuese** për të diskutuar funksionimin e ueb-faqeve zyrtare, konsultimet publike, buxhetimin me pjesëmarrje, ndërlihdjen e ueb-faqeve zyrtare të komunave me Platformën për Konsultime Publike në kuadër të ZKM-së dhe sfidat në përmbushjen e obligimeve ligjore për transparencë.

Në zhvillimin dhe avancimin e politikave lokale përmes hulumtimit dhe analizës, me fokus në vendimmarrje të bazuar në të dhëna dhe indikatorë që mbështesin qeverisjen e mirë në nivel lokal, janë ndërmarrë aktivitete të shumta që synojnë përmirësimin e cilësisë së politikave dhe praktikave institucionale.

4.2. Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut

Gjatë periudhës raportuese, MAPL ka vazhduar angazhimin në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel lokal, përmes koordinimit me komunat, monitorimit të mekanizmave lokalë dhe mbështetjes së iniciativave për avancimin e barazisë dhe përfshirjes sociale.

Aktivitetet e realizuara në kuadër të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në nivel lokal, me fokus të veçantë në mbrojtjen nga diskriminimi, të drejtat e fëmijës, parandalimin e trafikimit me njerëz, personat me aftësi të kufizuara, barazinë gjinore dhe përfshirjen e

komuniteteve jo-shumicë, janë zhvilluar nga MAPL në bashkëpunim me komunat dhe institucionet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe politikat shtetërore. Në këtë kuadër, MAPL ka ushtruar edhe rolin koordinues dhe monitorues ndaj komunave për zbatimin e mekanizmave lokalë për të drejtat e njeriut.

Në periudhën raportuese **janar–dhjetor 2025**, është hartuar Raporti për të Drejtat e Njeriut, i përgatitur në tri gjuhë, dhe i njëjti është finalizuar me sukses. Po ashtu, është hartuar edhe Raporti për Monitorimin e Treguesve për Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili është raportuar në ZKM/ZQM. Gjithashtu, është realizuar **raportimi i rregullt për zbatimin e Programit për të Drejtat e Njeriut në kuadër të Zyrës për Qeverisje të Mirë (ZQM) në Zyrën e Kryeministrit**.

Sipas raportimeve të pranuar nga komunat, gjithsej **30 komuna kanë raportuar në MAPL**, prej të cilave **24 komuna kanë njoftuar për emërimin e zyrtarit për mbrojtje nga diskriminimi**, duke shënuar progres në forcimin e mekanizmave lokalë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në kuadër të rolit të MAPL-së në fushën e parandalimit të trafikimit me njerëz, çdo vit, në koordinim me **Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB)**, MAPL hap fushatën vetëdijesuese në komunat e Republikës së Kosovës. Në kuadër të kësaj fushate organizohen aktivitete vetëdijesuese në nivel lokal, me përfshirjen e institucioneve komunale, shkollave dhe akterëve të tjerë relevantë. Bazuar në raportimet komunale, në kuadër të kësaj fushate vetëdijesuese **në 13 komuna kanë marrë pjesë mbi 18,000 deri në rreth 20,000 pjesëmarrës**, duke përfshirë kryesisht nxënës të arsimit fillor dhe të mesëm, mësimdhënës, si dhe përfaqësues institucional. Pas përfundimit të fushatës, MAPL mbledh të dhënat nga komunat përmes tabelave raportuese dhe harton raportin përkatës, i cili i dorëzohet MPB-së për përfshirje në **TIP Reportin** dhe për raportim ndaj **Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës**.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese, MAPL u është drejtuar **kryetarëve të komunave** me kërkesë për hapjen e fushatës vetëdijesuese për regjistrim falas të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunat e Kosovës. Kjo fushatë është zhvilluar gjatë muajit prill në nivel lokal, në bashkëpunim me institucionet komunale përkatëse, me qëllim të rritjes së qasjes në regjistrimin civil dhe përmirësimit të përfshirjes së këtyre komuniteteve në shërbimet publike. Bazuar në raportimet komunale dhe në të dhënat e viteve të fundit, **vërehet një përmirësim i dukshëm**, pasi numri i kërkesave për regjistrim të vonuar apo të paregjistruar ka shënuar rënie graduale.

Gjatë periudhës raportuese është filluar trajtimi i temës së luftimit të diskriminimit ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian si një formë specifike e diskriminimit ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Në bashkëpunim me komunat, MAPL ka filluar të adresojë këtë çështje përmes diskutimeve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese në nivel lokal, me qëllim të rritjes së vetëdijesimit institucionale dhe forcimit të mekanizmave për parandalimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë dhe përfshirjes së këtyre komuniteteve në shoqëri.

Sa i përket **barazisë gjinore**, gjatë vitit 2025 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka vazhduar angazhimin e saj në promovimin dhe avancimin e barazisë gjinore në nivel lokal, përmes koordinimit me komunat dhe mbështetjes së mekanizmave institucionalë në nivel lokal. Sipas raportimeve komunale, **27 komuna kanë të hartuara Planet e Veprimit për Barazi**

Gjinore, të cilat shërbejnë si instrumente të rëndësishme për integrimin e perspektivës gjinore në politikat dhe aktivitetet komunale.

Gjatë kësaj periudhe, MAPL ka hartuar edhe një **qarkore që adreson pabarazinë gjinore në nivel lokal**, përmes ndërmarrjes së masave të veçanta brenda organeve komunale, me qëllim të promovimit të përfaqësimit të barabartë dhe përmirësimit të qasjes së grave dhe burrave në proceset vendimmarrëse dhe në pozitat drejtuese në nivel lokal. Qarkorja është miratuar nga **Sekretari i MAPL-së** dhe është hartuar në përputhje me rekomandimet e **Institucionit të Avokatit të Popullit**.

Përmes këtyre veprimeve, MAPL ka kontribuar në forcimin e mekanizmave institucionale për barazi gjinore në nivel lokal dhe në rritjen e vetëdijes institucionale për zbatimin e parimit të barazisë gjinore në qeverisjen lokale.

Vlen të përmendet se është organizuar edhe një **punëtori për ngritjen e nivelit strukturor të Njësive për të Drejta të Njeriut (NJDNJ) dhe Zyrave për Komunitete dhe Kthim në komuna**. Gjithashtu janë mbajtur punëtori rajonale, nga të cilat janë nxjerrë rekomandime konkrete për përmirësimin e funksionimit institucional të këtyre mekanizmave në nivel lokal.

Fokus i veçantë është orientuar edhe në **avancimin e qasjes dhe punësimit të personave me aftësi të kufizuara**. Në këtë drejtim, MAPL u është drejtuar komunave me kërkesë për ndërmarrjen e masave konkrete për përmirësimin e qasjes dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në nivel lokal. Në bashkëpunim me **Shoqatën e të Shurdhërve** është iniciuar procesi i hartimit të **Planeve të Veprimit në 10 komuna**, për adresimin e çështjeve të qasjes dhe përfshirjes.

Gjithashtu, MAPL u është drejtuar **Kryetarëve të Komunave** me kërkesë për vendosjen e gjuhës së shenjave në ueb-faqet zyrtare të komunave. Deri më tani, **katër (4) komuna** kanë filluar zbatimin e kësaj mase, duke përfshirë gjuhën e shenjave në komunikimin institucional.

Në kuadër të zbatimit të **Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës**, MAPL ka hartuar **matricën për monitorimin e Ekipeve për të Drejtat e Fëmijës (EDF)** në komuna, në përputhje me **Udhëzimin Administrativ (QKR) Nr. 06/2022 për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës**, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më **15 gusht 2022**. Kjo matricë është përgatitur me mbështetjen e **Save the Children** dhe në bashkëpunim me **ZQM/ZKM dhe organizatën Syri i Vizionit**, duke krijuar një mekanizëm të strukturuar për monitorimin dhe vlerësimin e funksionimit të këtyre mekanizmave në komuna.

Në kuadër të avancimit të mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, janë organizuar edhe **trajnime me përgjegjësit e Ekipeve për të Drejtat e Fëmijës në komuna**, si dhe është ofruar mbështetje profesionale për **hartimin e Planeve të Punës për të Drejtat e Fëmijës** në disa komuna. Po ashtu, është hartuar një raport për zbatimin e planeve të punës nga **Ekipeve për të Drejtat e Fëmijës**, ku sipas të dhënave të raportuara **20 komuna kanë miratuar Planet e Veprimit**, duke dëshmuar përkushtim institucional për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Gjithashtu, është hartuar një **raport për përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve në përdorim zyrtar në komunat e caktuara**, me qëllim të vlerësimit të zbatimit të obligimeve ligjore.

Këto aktivitete dëshmojnë se MAPL ka pasur **angazhim të vazhdueshëm dhe progres në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel lokal**. Përmes bashkëpunimit ndërinstucional me *Zyrën e Kryeministrit/Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZKM/ZQM)*, *Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ)*, *ministrinë e linjës dhe në veçanti me Njësitë për të Drejtat e Njeriut në komuna*, është arritur të forcohen mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel lokal.

MAPL ka bashkëpunuar gjithashtu me **partnerë ndërkombëtarë dhe vendorë**, përfshirë: *Syri i Vizionit*, *UN Women*, *Save the Children*, *UNICEF*, *OSBE*, *Terre des Hommes*, si dhe organizata të komuniteteve si *Zëri i Romëve*, *Ashkalive dhe Egjiptianëve*, të cilat kanë kontribuar në avancimin e politikave për të drejtat e njeriut, ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe promovimin e përfshirjes së grupeve të ndjeshme në nivel lokal.

4.3. Zhvillimi i kapaciteteve institucionale

Gjatë vitit 2025, departamenti për qeverisje të mirë në nivel lokal ka realizuar me sukses aktivitetet e planifikuara për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë.

Fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore përmes trajnimeve, gjatë vitit 2025, ka arritur të realizoj gjithsej 18 module të trajnimeve, në bashkëpunim me donatorë si OSBE, DEMOS, GIZ, Këshilli Evropës dhe IKAP. Përfitues të trajnimeve ishin **374 zyrtarë komunal dhe të MAPL-së**.

Në fillim të vitit është hartuar **Plani i Trajnimeve për vitin 2025**, i miratuar dhe zbatuar gjatë vitit 2025, si pjesë e integruese e planit të punës, i cili ka pasur për qëllim identifikimin e hershëm të nevojave që të pasqyrohen më lehtë në planin e trajnimeve. Të dhënat janë marr nga pyetëtori standard për Komuna, që i është dërguar 38 komunave, për vlerësimin e nevojave për trajnime.

Janë realizuar 5 vizita në komuna për njoftim dhe vlerësim të gjendjes së kapaciteteve, përkatësisht në:



Në fund, Departamenti për Qeverisje të Mirë në Nivel Lokal, ka përgatitur edhe **Raportin për Vlerësimin e nevojave për ngritje të kapaciteteve të zyrtarëve komunal**, bazuar në nevojat e identifikuarat përmes përgjigjeve të pranuarat nga komunat nga pyetëtori i dërguar.

Rezultatet Kryesore;

- Rritje e numrit të trajnimeve dhe e pjesëmarrësve krahasuar me planifikimin fillestar,

- Identifikim më i saktë i nevojave për trajnim në nivel komunal,
- Përfshirje e nevojave të departamenteve të tjera brenda MAPL-së në planifikimin e trajnimeve,
- Bashkëpunim i suksesshëm me donatorë ndërkombëtarë.

Janë zhvilluar **5 takime me institutet hulumtuese** me fokus në qeverisjen lokale, për të rritur cilësinë e dokumenteve, hulumtimeve dhe analizave strategjike. Bashkëpunimet janë zgjeruar edhe përmes dy takimeve me sektorin e ICT-ve për integrimin e teknologjisë në procesin e analizave dhe raportimit, një takimi me një organizatë ndërkombëtare për shkëmbim praktikash, si dhe dy takimeve me institucionet shtetërore ZQM dhe IKAP për koordinim mbi implementimin e praktikave të qeverisjes së mirë.

Tek pjesa e hartimit të analizave të brendshme, Divizioni për Hulumtim dhe Analiza ka përfunduar **analizën dhe hulumtimin rreth transparencës** në nivelin komunal dhe pyetësorin për transparencë të MAPL-së, në kuadër të zbatimit të UA 04/2023 MAPL. Për më tepër është hartuar **draft-analiza për orientime strategjike** dhe trendët e reja në fushën e ngritjes së kapaciteteve institucionale të nëpunësve civil. Këto aktivitete kanë kontribuar në përmirësimin e cilësisë së politikave lokale dhe vendimmarrjes bazuar në të dhëna, duke forcuar mekanizmat e qeverisjes së mirë dhe promovuar transparencën dhe efikasitetin në nivel lokal.

V. AVANCIMI I QEVERISJES SË HAPUR DHE I SHËRBIMEVE DIGJITALE NË NIVEL LOKAL

Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe (Janar – Dhjetor, 2025) janë ato të cilat ndërlidhen me:

- Zhvillimin dhe implementimin e Platformës shtetërore E-Komuna
- Avancimin e Partneritetit për Qeverisje të Hapur; dhe
- Forcimin e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile.

5.1. Zhvillimi i Platformës Shtetërore E-Komunat

Zhvillimi i qeverisjes digjitale dhe avancimi i konceptit të qyteteve inteligjente (Smart City) përbën një nga drejtimet kryesore të modernizimit të qeverisjes lokale dhe përmirësimit të ofrimit të shërbimeve publike për qytetarët. Në këtë kuadër, është finalizuar dhe publikuar **Raporti Vjetor për Qytetet e Mençura dhe Platformën e-Komuna**, i cili paraqet progresin e arritur në digjitalizimin e shërbimeve komunale dhe në krijimin e mekanizmave të rinj për transparencë, pjesëmarrje qytetare dhe efikasitet institucional.

Në funksion të avancimit të këtij procesi, zhvillimi i platformës shtetërore E-Komuna ka për qëllim kryesor udhëheqjen dhe koordinimin e procesit të digjitalizimit të shërbimeve komunale përmes një platforme kombëtare të unifikuar, si dhe avancimin e politikave për Qytetet Inteligjente (Smart City). Ky proces synon sigurimin e harmonizimit të plotë me Strategjinë Kombëtare për Qeverisje


Elektronike dhe me prioritetet qeveritare për transformim digjital. Platforma E-Komuna shërben si mekanizëm qendror për integrimin e inovacionit digjital me qeverisjen lokale, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit institucional, përmirësimin e aksesueshmërisë së shërbimeve për qytetarët dhe rritjen e transparencës në nivel kombëtar dhe lokal. Aktualisht, platforma E-Komuna përbëhet nga dhjetë **(10) module funksionale** të cilat mbështesin ofrimin dhe menaxhimin e shërbimeve komunale në mënyrë elektronike;

- Transmetimet direkte të mbledhjeve të asambleve komunale,
- Raporto problemet në komunën tuaj,
- Komuniko me zyrtarin komunal,
- Inicio dhe kontribuo në debatet publike për komunën tuaj,
- Leje dhe procedura në debate publike për komunën e Prizrenit,
- Leje dhe procedura në debate publike për komunën Lipjanit,
- Grantet dhe subvencionet komunale,
- Regjistri i tatimeve komunale,
- Regjistri i investimeve kapitale,
- Regjistri i pronave të paluajtshme të komunave, sipas legjislacionit përkatës për dhënien në shfrytëzim të pronës.

Megjithatë, një nga sfidat kryesore mbetet fillimi i Fazës III të platformës E-Komuna, e cila parashikon plotësimin dhe zhvillimin e moduleve të reja, bazuar në të gjitha inputet, kërkesat dhe rekomandimet e pranuar nga komunat. Një sfidë shtesë paraqet edhe implementimi i platformës nga ana e komunave, për shkak të dallimeve në kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore, çka ndikon drejtpërdrejt në ritmin dhe nivelin e zbatimit të platformës në nivel lokal.

Aktualisht, tri komuna pilot – Prishtina, Gjlani dhe Mitrovica e Jugut – janë të populluara me të dhëna në platformën E-Komuna. Synimi është që deri në fund të vitit 2026, të gjitha komunat të jenë plotësisht të integruara, duke ofruar qasje të plotë dhe të unifikuar në shërbime elektronike, pa barriera administrative. Ky objektivi përfaqëson një prioritet kombëtar dhe një hap të rëndësishëm drejt transformimit digjital në nivel lokal.

MAPL do të vazhdojë të ofrojë mbështetje të vazhdueshme për komunat në ngritjen e kapaciteteve teknike dhe administrative, si dhe në zbatimin e Strategjisë për Qytete Inteligjente 2025–2028, në mënyrë që transformimi digjital të jetë i qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe i orientuar drejt nevojave të qytetarëve.



5.2. Avancimi i partneritetit për qeverisje të hapur

Procesi i avancimit të qeverisjes së hapur dhe forcimit të pjesëmarrjes qytetare përbën një komponent të rëndësishëm të përmirësimit të transparencës, llogaridhënies dhe gjithëpërfshirjes në vendimmarrjen publike. Në këtë kuadër, është iniciuar procesi për hartimin e **Planit të Veprimit 2026–2028 Partneriteti dhe Qeverisja e Hapur (PQH)**, i cili synon të krijojë mekanizma më efektivë për bashkëpunim ndërmjet institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve. Hartimi i këtij plani është zhvilluar përmes një procesi konsultativ dhe gjithëpërfshirës, duke siguruar që prioritetet dhe veprimet e përcaktuara të reflektojnë nevojat reale të institucioneve dhe të shoqërisë.

Në kuadër të këtij procesi janë organizuar një sërë aktivitetesh konsultuese dhe koordinuese, duke përfshirë takime të grupit punues, webinarë informuese dhe takime të drejtpërdrejta me organizatat e shoqërisë civile. Po ashtu, janë zhvilluar anketa të veçanta për institucionet publike, organizatat joqeveritare dhe qytetarët, me qëllim mbledhjen e komenteve, rekomandimeve dhe prioritetëve për avancimin e parimeve të qeverisjes së hapur. Ky proces synon të sigurojë një qasje më të strukturuar dhe bashkëpunuese në hartimin dhe zbatimin e politikave publike, duke kontribuar në rritjen e transparencës institucionale, forcimin e llogaridhënies dhe zgjerimin e mundësive për pjesëmarrje aktive të qytetarëve në vendimmarrje.

Si rezultat i këtij procesi gjithëpërfshirës, pritet që Plani i Veprimit 2026–2028 Partneriteti dhe Qeverisje të Hapur të shërbejë si një kornizë e rëndësishme për thellimin e reformave në fushën e transparencës, pjesëmarrjes dhe llogaridhënies publike. Zbatimi i tij do të kontribuojë në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe shoqërisë civile, si dhe në krijimin e mekanizmave

më efektive për përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse, duke mbështetur kështu zhvillimin e një qeverisjeje më të hapur dhe më demokratike.

5.3. Bashkëpunimi me Shoqërinë Civile

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka vazhduar në mënyrë të qëndrueshme përfshirjen aktive të shoqërisë civile në procesin e hartimit të politikave dhe legjislacionit për vetëqeverisje lokale, si dhe në zbatimin e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016–2026. Gjatë kësaj periudhe, në çdo grup themelues të angazhuar në hartimin e politikave dhe akteve ligjore të ministrisë është përfshirë përfaqësues nga shoqëria civile. Kjo qasje ka kontribuar në rritjen e transparencës, gjithëpërfshirjes dhe bashkëpunimit ndërinstytucional.

Në kuadër të forcimit të mëtejshëm të këtij bashkëpunimi dhe në përputhje me standardet e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP) për pjesëmarrje dhe bashkë-krijim të politikave publike, MAPL ka themeluar edhe një **forum të përbashkët me organizatat e shoqërisë civile**. Ky forum do të shërbejë si mekanizëm konsultativ dhe platformë e strukturuar për dialog të rregullt ndërmjet institucioneve dhe shoqërisë civile, me qëllim të rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes në proceset vendimmarrëse.

Përmes përfshirjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile në grupet punuese dhe përmes funksionimit të këtij forumi, është mundësuar reflektimi më i mirë i nevojave dhe interesave të komuniteteve lokale në politikatat dhe aktet normative të hartuara nga ministria. Si rezultat, proceset e hartimit të politikave janë bërë më gjithëpërfshirëse, më transparente dhe më të qëndrueshme.

5.4. Informimi i Publikut për Aktivitetet e MAPL-së

Në kuadër të komunikimit publik dhe promovimit të aktiviteteve të MAPL-së në raport me publikun, gjatë periudhës raportuese janë realizuar aktivitete të vazhdueshme informuese rreth **750** publikime. Këto aktivitete janë pasqyruar rregullisht në ueb-faqen zyrtare të MAPL-së (<https://mapl.rks-gov.net/>), përmes publikimit të dokumenteve, njoftimeve dhe lajmeve me karakter informues. Njëkohësisht, rrjeti social Facebook i MAPL-së është shfrytëzuar si kanal për informim dhe komunikim me publikun.

Me qëllim të avancimit të transparencës dhe llogaridhënies institucionale, MAPL ka siguruar publikimin e **raporteve të punës, planet e punës, thirrjet për propozime, si dhe raporte të auditimit**.

Në bashkëpunim me mediat, qytetarët, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile, MAPL ka trajtuar në mënyrë të vazhdueshme pyetjet, kërkesat dhe ankesat e pranuar. Ky bashkëpunim ka mundësuar përmirësimin e komunikimit dhe shkëmbimin efikas të informatave. Në veçanti, është siguruar qasje në **11 dokumente zyrtare** në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sa i përket bashkëpunimit me komunitetin, janë organizuar trajnime dhe punëtori të ndryshme me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të zyrtarëve për informim në nivel lokal. Këto aktivitete janë

realizuar me përkrahjen e donatorëve dhe kanë kontribuar në forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional, si dhe në shkëmbimin e njohurive dhe praktikave të mira.

VI. ADMINISTRATA, SHËRBIMET E PËRGJITHSHME, FINANCAT, AUDITIMI DHE PROKURIMI

Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe (Janar – Dhjetor, 2025) janë ato të cilat ndërlidhen me:

- Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Mbështetje logjistike, teknike dhe administrative të MAPL-së;
- Menaxhimi i financave;
- Auditimin e aktiviteteve; dhe
- Shërbimet e Prokurimit.

6.1. Menaxhimi i burimeve njerëzore

Gjatë vitit 2025, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka realizuar me sukses aktivitetet e planifikuara në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore në MAPL.

Në kuadër të rekrutimit, janë pranuar dhe proceduar **34 kërkesa inicuese** për pozita të lira, të aprovuara nga udhëheqësit përkatës dhe Sekretari i Përgjithshëm. Të gjitha konkurset janë shpallur në dy gjuhët zyrtare përmes SIMBNJ dhe ueb-faqes së MAPL-së, ndërsa janë hartuar vendimet për Komisionin e Rekrutimit dhe janë publikuar njoftimet për kandidatët e suksesshëm. Janë pranuar kërkesa për praktikë dhe për të njëjtat janë nënshkruar marrëveshjet si dhe është bërë regjistrimi elektronik i studentëve të cilët kanë kryer praktikën në këtë periudhë.

Sa i përket zhvillimit profesional të stafit, NJMBNJ ka bërë identifikimin e nevojave, ka grumbulluar kërkesat për trajnime nga njësitë organizative dhe ka hartuar **Planin Vjetor të Trajnimeve për vitin 2025**, ku edhe janë hartuar raportet mbi mbarëvajtjen e trajnimeve.

Në fushën e administrimit të pagave, NJMBNJ ka pranuar dhe proceduar në mënyrë të rregullt, çdo muaj, të gjitha kërkesat e aprovuara për ndryshime dhe kompensime në listën e pagave, të cilat janë përcjellë me kohë në Divizionin e Pagave – Thesar. Janë përgatitur raportet mujore të vijueshmërisë për stafin, janë proceduar ID kartelat e reja.

Në bashkëpunim me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, janë realizuar njoftime të rregullta për deklarimin e pasurisë për zyrtarët e MAPL-së, përfshirë deklarimin vjetor dhe rastet e marrjes apo lirimit nga detyra.

Në përfundim, aktivitetet e NJMBNJ për vitin 2025 janë realizuar në përputhje me planifikimin dhe legjislacionin në fuqi, duke kontribuar në funksionimin efikas dhe transparent të MAPL-së.

6.2. Shërbimet e Përgjithshme

Gjatë vitit 2025, Departamenti për Shërbime të Përgjithshme ka realizuar me sukses aktivitetet e planifikuara, duke ofruar mbështetje logjistike, teknike dhe administrative për funksionimin e rregullt të Ministrisë dhe njësive të saj organizative.

Në kuadër të ofrimit të shërbimeve logjistike, është siguruar asistencë teknike për organizimin e **10 takimeve në nivel Ministrie** dhe **28 takimeve** të organizuara nga departamentet dhe divizionet. Kjo ka përfshirë përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve, vendosjen e pajisjeve teknike, banerëve, panove, si dhe pajisjeve të zërimit dhe përkthimit.

Departamenti ka menaxhuar mirëmbajtjen, kontrollin dhe sigurinë e automjeteve zyrtare. MAPL disponon me gjithsej **10 automjete zyrtare**, të cilat gjatë vitit kanë qenë të sigurta, të regjistruara dhe funksionale. Transporti për zyrtarët brenda dhe jashtë vendit është realizuar në mënyrë të rregullt dhe në kohë, pavarësisht sfidave të evidentuara si numri i pamjaftueshëm i automjeteve dhe mungesa e vozitësve për shkak të lirimit nga detyra të dy vozitësve.

Gjatë vitit 2025 është funksionalizuar platforma **e-pasuria**, ku janë regjistruar të gjitha lëvizjet e inventarit për zyrtarët e Ministrisë. Gjithashtu, të gjitha kërkesat për furnizim me material shpenzues janë realizuar me kohë dhe pa pengesa.

Në fushën e teknologjisë informative, Departamenti ka ofruar shërbime të rregullta të IT-së, përfshirë mirëmbajtjen e rrjetit të internetit, Help Desk-un, instalimet, printimin dhe shërbimet elektronike. Rrjeti funksionon në domain të ASHI-së, ndërsa përkrahja për komunat në sistemin e Intranetit është realizuar përmes pjesëmarrjes në komisionin teknik për monitorimin e operatorit ekonomik. Furnizimi me pajisje IT (PC dhe laptop) është bërë sipas nevojave të zyrtarëve.

Departamenti ka ofruar shërbime të përkthimit, lektorimit dhe arkivimit të dokumenteve. Të gjitha dokumentet zyrtare të Ministrisë janë përgatitur në dy gjuhët zyrtare dhe, sipas nevojës, edhe në gjuhën angleze. Gjatë vitit janë mbuluar së paku **20 takime** me përkthim simultan dhe konsektiv. Çdo dokument është lekturuar para përkthimit.

Sa i përket menaxhimit të dokumentacionit, gjatë periudhës janar–dhjetor 2025 janë protokoluara gjithsej **3,736 dokumente**, të cilat janë procesuar në përputhje me afatet ligjore për vetëqeverisje lokale. Arkivi, regjistrat dhe dokumentet e Ministrisë janë menaxhuar dhe sistemuar në mënyrë elektronike dhe fizike.

Në përfundim, Departamenti për Shërbime të Përgjithshme ka përmbushur me sukses të gjitha aktivitetet e planifikuara për vitin 2025, duke siguruar mbështetje efikase dhe të vazhdueshme për funksionimin e Ministrisë, pavarësisht sfidave të identifikuara në aspektin e burimeve njerëzore dhe logjistike.

6.3. Menaxhimi i financave

Menaxhimi i procesit të planifikimit, monitorimit dhe shpenzimit të buxhetit të MAPL-së, ka filluar më mbledhjen e informatave nga njësit lidhur me kohën e paraparë për zotimin dhe shpenzimin e mjeteve. Mbi bazën e të dhënave për zotime dhe shpenzime në SIMFK është hartuar dhe dorëzuar Plani i Zotimeve dhe Shpenzimeve në Ministrinë e Financave. Divizioni për Buxhet

dhe Financa, gjatë periudhës raportuese ka bërë edhe ndryshimin e këtij plani sipas nevojës së MAPL-së me kërkesë paraprake në Ministrinë e Financave.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është përcjell rrjedha e alokimit të mjeteve dhe janë bërë ndryshime për planin e shpenzimeve. Sa i përket raportit vjetor financiar për vitin e përfunduar 2024, është dorëzuar në MFPT dhe gjithashtu janë kryer të gjitha regjistrimet e pasurisë dhe stoqeve. Për sigurimin e kodeve për projektet kapitale, janë përgatitur dhe dorëzuar kërkesat dhe fletë alokimi për MFPT, janë kompletuar lëndët me MeM dhe PIP dhe janë alokuar mjetet për projektet e reja. Është përgatitur dhe dorëzuar Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2026-2028. Sa i përket kërkesave buxhetore për vitin 2026, pas pranimit të Qarkores buxhetore për vitet 2026-2028 janë identifikuar nevojat buxhetore dhe është dorëzuar kërkesa buxhetore. Është përgatitur hartimi i Programit të Investimeve Publike (PIP) në bazë të qarkores së parë buxhetore, janë përgatitur dhe janë vendosur në sistemin BDMS shpenzimet në bazë të qarkores së parë buxhetore.

Gjatë kësaj periudhe është përgatit; **Raporti për listën e rreziqeve për vitin 2024 dhe 2025, si dhe Raporti i listës së vetëvlerësimit për vitin 2024.**

Për zotime, pranim të mallit, shpenzim dhe certifikim të lëndëve për pagesa janë pranuar kërkesat inicuese për zotimin e mjeteve në SIMFK, janë pranuar lëndët dhe faturat për procedim të pagesave dhe janë evidentuar në librin e protokollit, është bërë përgatitja CPO-së dhe është kryer regjistrimi i zotimeve, shpenzimeve dhe certifikimi në SIMFK, është kryer pranimi i mallit në SIMFK dhe evidentimi në librin e protokollit intern, është bërë skanimi i lëndëve, arkivimi elektronik në Share Folder si dhe arkivimi fizik i lëndëve.

Gjatë kësaj periudhe është bërë raportimi, barazimi i raportit të SIMFK dhe analizimi i tij me raportet e shpenzimeve për periudhën Janar - Dhjetor 2024 dhe në baza mujore për periudhën janar - dhjetor 2025. Ndërsa sa i përket objektivit *Paraja e imët (Petty Cash)* dhe *Avanse për udhëtime zyrtare*, është bërë hapja e petty cashit për administratë dhe për kabinet, është bërë përgatitja e fletëpranimit standard të parasë së imtë dhe vendosja e të dhënave në çarshaf për kërkesat e bërë për Petty Cash, është bërë përgatitja e formularëve dhe llogaritja e shpenzimeve para dhe pas kthimit të zyrtarëve nga vizita zyrtare, është bërë tërheqja e parave të gatshme nga banka komerciale dhe kthimi i mjeteve në rastet kur ka pasur kthim të mjeteve dhe është bërë mbyllja e Kredit Karteleve në rastet kur ka pasur shpenzime.

Për raportimin e obligimeve të papaguara dhe obligimeve kontraktuale në vazhdimësi janë përgatitur dhe dorëzuar raportet mujore për faturat e papaguara dhe obligimeve kontraktuale. Ndërsa për hartimin e raporteve mujore financiare dhe raporteve tjera mbi shpenzimet e përgjithshme, janë përgatitur raportet javore për buxhetin e përgjithshëm për MAPL-në zotimi, shpenzimi dhe certifikimi. Janë hartuar raportet e kontabilitetit mbi shpenzimet e përgjithshme, janë dorëzuar raportet javore të buxhetit dhe në vazhdimësi janë kontrolluar lëvizjet buxhetore. Për menaxhimin e pasurisë së MAPL-së gjatë kësaj periudhe është kryer: regjistrimi i pasurisë mbi 1,000.00 € në SIMFK, regjistrimi i pasurisë në sistemin e-pasuria dhe bartja e investimeve kapitale në komuna pas përfundimit të projekteve.

Është përgatitur dhe dorëzuar **Raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit Gjeneral**, si dhe plani i veprimit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike sipas vendimit të Qeverisë.

*Buxheti i MAPL-së për vitin
2025 së bashku me
donacione është
6,139,156.76 €
ku nga kjo shumë për
periudhën Janar – Dhjetor
2025 janë shpenzuar
5,332,600.33 €
ose
86.86 %*

Buxheti i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për vitin 2025, (bazuar në raport të datës 30.01.2026 për vitin 2025), së bashku me Donacionin (93 European Commission), në total është **6,139,156.76 €**. Nga kjo shumë për periudhën janar – dhjetor janë shpenzuar në total **5,332,600.33 €**, ose **86.86%**. Buxheti i MAPL-së, për vitin 2025, ishte **5,818,227.63€**, ndërsa është shpenzuar **5,178,109.72€** ose **89%**. Buxheti i European Commission për vitin 2025, ishte **320,929.61€**, ndërsa është shpenzuar **154,490.61€** ose **48.13%**.

6.4. Auditimi i Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) ka filluar punën e vitit 2025, duke hartuar raportin e gjashtëmujorit të II-të për periudhën korrik-dhjetor 2024, raportin vjetor të punës për periudhën janar-dhjetor 2024, të cilat pas aprovimit nga ana e Udhëheqësit të Subjektit të Sektorit Publik/ Ministri janë proceduar tek menaxhmenti i lartë i MAPL-së, Komitetit i Auditimit dhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm (NJQH-AB).

Sipas planifikimit vjetor 2025, janë kryer të gjitha aktivitetet në përputhje me Planin vjetor 2025, NJAB ka përfunduar auditimet si në vijim:

- “Menaxhimi i automjeteve në MAPL”
- “Menaxhimi i burimeve njerëzore në MAPL”

Është përgatitur raporti i gjashtëmujorit të I-rë pas aprovimit nga ana e Udhëheqësit të Subjektit të Sektorit Publik/ Ministrit është proceduar në NJQH-AB tek menaxhmenti i lartë i MAPL-së dhe Komiteti i Auditimit, 15.07.2025.

Gjatë vitit 2025 janë mbajtur vetëm dy takime me Komitetin e Auditimit të Brendshëm për arsyes se Komitetit të Auditimit është formuar me datë 05.08.2025.

Gjithashtu janë finalizuar raportet si në vijim:

- “Sistemi i menaxhimit të buxhetit”
- “Sistemi i menaxhimit të prokurimit”
- “Menaxhimi i investimeve kapitale në MAPL për vitin 2025”.

Është përgatitur Plani Strategjik 2026-2028 dhe Plani Vjetor i NJAB-së për vitin 2026 dhe pas miratimit nga Komiteti i Auditimit dhe Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik/ Ministri janë dërguar në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve konkretisht në Njësinë Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm NJQH-AB, datë 24.12.2025.

6.5. Prokurimi

Aktivitetet e Divizionit të Prokurimit për vitin 2025 kanë filluar me grumbullimin dhe përpunimin e kërkesave për mallra, shërbime dhe investime kapitale nga departamentet përkatëse të MAPL-së. Këto kërkesa janë harmonizuar dhe përmbyllur në kuadër të planifikimit përfundimtar për vitin fiskal vijues. Plani i Prokurimit është finalizuar dhe proceduar për miratim te Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së, si dhe është publikuar në platformën elektronike të KRPP-AQP-së, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Në kuadër të Planit të Prokurimit janë zhvilluar aktivitete për realizimin e kontratave të planifikuara, përfshirë **kontrata për furnizim** dhe **kontrata për shërbime**, në koordinim të vazhdueshëm me departamentet përkatëse, duke siguruar transparencë dhe efikasitet në procesin e prokurimit.

Në përputhje me kërkesat e Departamenteve janë realizuar artikujt si: Furnizim me material shpenzues, furnizim me kalendar për tavolinë pune më llogo të MAPL-ës, frigorifer për nevoja të stafit, furnizim dhe rimobilim i zyrave (Kabinet, Administratë), furnizim me fletore me llogo të MAPL-së, së formatit A5 dhe A4 me kopertina të trasha, kimika me llogo, furnizimi me pajisje tjera të IT-së, furnizim me laptop dhe kompjuter PC, etj. Ndërsa, tek shërbimet janë realizuar; Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve të veturave, pastrimi i veturave zyrtare të MAPL-ës, shërbime të shtypi, printim, kontrollimi teknik i automjeteve, mirëmbajtja e SMPK-së, shërbime të transportit ajror për nevojat e MAPL –së etj. Të gjitha këto aktivitete janë bërë konform Ligjit për Prokurim Publik. Për furnizime apo shërbime të tjera, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa inicuese.

Gjithashtu, në këtë periudhe **është hartuar Raporti i Kontratave të nënshkruara për vitin 2025.**